

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

**26.10.2023
Ora 13:13**

RENDI I DITËS

**"Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë
19.10.2023".**


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S'ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dhimitër Zguri)

Z. K.Beles: Përshëndetje! Çelim seancën publike për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për vendosje sanksioni administrativ" drejtuar KAS-it, lidhur me kërkesën ankimore nr. 32 të iniciuar nga Qendra Qëndresa Qytetare, për shkeljen administrative nga ana e kandidatit për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe nga ana e drejtorit të Shkollës 9-vjecare "Fran Murrizi" në Pjetrosan, Malësi e Madhe. Në seancën e kaluar u vendos kalimi i kësaj kërkesë për shqyrtim dhe sot jemi për shqyrtimin e saj në themel. Prezent janë 5 anëtarët e KAS-it si edhe administrata e KQZ-së e drejtuar nga Sekretari i Përgjithëm. Ka palë të tjera të interesuara?

Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Po, Qëndresa Qytetare.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. K. Bele: A keni qenë në shqyrtimin administrativ?

Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Po, kemi qenë palë, kemi qenë denoncuesi i këtij kallëzimi.

Z. K. Bele: Gjithsesi legjitimoheni për të qenë palë në këtë proces. Vazhdojmë me një relativitet shumë të shkurtër nga Sekretari i Përgjithshëm pasi dhe kauzusi është i përmbledhur. Të lutem, do të doja qëndrimin tuaj paraprakisht lidhur me diskutimin për marrjen ose jo dijeni nga ana e drejtorit, pasi për çështjen relatuat dhe rradhën e kaluar.

Z.Y. Merkaç: Komisioni Qëndrori i Zgjedhjeve ka marrë denoncimin me nr 413 ID nga Qëndresa Qytetare për shkelje administrative nga ana e kryetarit njëkohësisht kandidat për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe dhe nga ana e drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi” në Pjetroschan, Malësi e Madhe, në të cilët pretendohet se është zhvilluar një aktivitet i paligjshëm. Në mbështetje të nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, çështja është shqyrtuar paraprakisht dhe është vlerësuar si informacion i plotë apo të dhënat e treguara, krijojnë bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nisur hetimin administrativ duke i thirrur dhe palët në proces. Administrata e KQZ-së ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresave të postës elektronike marrjen e informacionit për rrethanat e çështjes. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria Arsimore Malësi e Madhe, ka kthyer përgjigje se nuk ka qenë në dijeni në lidhje me takimin e zhvilluar në datën 03.05.2023, ndërsa drejtori i shkollës “Fran Murrizi” ka pretenduar se në datën 03.05.2023, stafi pedagogjik i shkollës ka qëndruar në punë si zakonisht deri në orën 14:00. Në përfundim të procesit mësimor

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

ka mbyllur dyert e shkollës dhe janë larguar në shtëpi. Nuk kanë pasur dijeni për zhvillimin e këtij takimi dhe as kontakte me personat që do të zhvillonin këtë takim. Drejtori i shkollës thekson se asnjë nga stafi pedagogjik nuk është banor i këtij fshati kështu që pretendon se nuk ka pasur dijeni dhe nuk ka asnjë përgjegjësi për zhvillimin e këtij takimi. Gjatë hetimit administrativ dhe evidentimit të deklarimit të mbajtur dhe postimet në faqen publike zyrtare në Facebook të kandidatit Tonin Marinaj është konstatuar se ky takim elektorale është zhvilluar në ambientet e oborrit të Shkollës “Fran Murrizi”. Gjatë hetimit administrativ dhe materiale të administruara në dosjen hetimore, Komisioneri vlerëson se të dy këta persona janë përgjegjës për zhvillimin e takimit elektorale në ambientet e Shkollës “Fran Murrizi”, drejtori i shkollës 9-vjeçare si dhe kandidati, njëkohësisht kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe. Në këto kushte Komisioneri i ka prozouar KAS-it për marrjen e masës administrative në masën 3 mijë lekë për kryetarin e bashkisë dhe në masën 3 mijë për drejtorin e Shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”. Atëherë në lidhje me pretendimet e drejtorit të shkollës që nuk ka marrë njoftim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka komunikuar me zyrën arsimore të Malësisë së Madhe dhe ata kanë marrë përsipër ta njoftonin drejtorin e shkollës duke qenë se është edhe pjesë e personelit të Zyrës Arsimore kanë pasur kontaktin e tyre dhe na kanë kthyer përgjigje që e kanë njoftuar për zhvillimin e seancave administrative në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Z. K. Bele: Duke lexuar materialin unë shoh se ka dy momente që më tërhoqën vëmendje, e para është qëndrimi.. pretendimi i drejtorit në komunikimin me ju, që dhe e relatuat, “aktiviteti është zhvilluar në oborrin e jashtëm dhe pas orarit zyrtar dhe për këtë shkak ne nuk kemi dijeni”. E dyta, është pretendimi i kandidatit i cili shpjegon në një e-mail që ju ka kthyer përgjigje, ku thotë “aktiviteti është nisur të mbahet në sheshin e fshatit por për pamundësi, ka pasur një diskutim që është sheshi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

i fshatit apo është pronë private dhe e kemi zhvilluar aty”. I keni hetuar këto dy pretendime ose keni pasur mundësi t’i hetoni dhe çfarë qëndrimi keni? Në lidhje me këtë të njëjtën pyetje do t’ia bëja dhe përfaqësuesit të Qëndresës nëse ka ndonjë qëndrim lidhur me këtë moment. Pasi ne duhet të verifikojmë në rastin e drejtorit të pasurit ose jo dijeni të paktën për këtë rast.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj pothuajse në të njëjtën linjë, nga hetimi administrativ që ju keni bërë, një hetim administrativ gati 5 mujor që shoh për këtë rast, a keni arritur dot të dilni në përfundimin, nëse drejtori i shkollës ka pasur mundësitë objektive për të ndaluar këtë aktivitet dhe nuk e ka kryer? Apo del që ai ka qenë në pamundësi objektive për ta ndaluar këtë aktivitet?

Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se drejtori i shkollës ka pasur dijeni që takimi do të zhvillohej në oborrin e kësaj shkolle dhe nuk ka marrë asnjë masë, qoftë dhe nga ana formale të ketë komunikuar me personat që do të organizonin takimin, që ky takim është i paligjshëm dhe nuk do të bëhet në ambientin e kësaj shkolle.

Z. K. Bele: Më fal Ylli, kur thoni “konstatuar” del si rrjedhim logjik apo ka ndonjë të dhënë, ndonjë dëshmitar apo një shkresë?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk kemi.

Z. K. Bele: Me sa kam lexuar unë praktikën, ai thotë “nuk di gjë”. Kur thoni “ka pasur dijeni”, ku mbështeteni?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi ...

Z. E. Lako: Në vijim të kësaj, gjatë hetimit, ka dalë që ky drejtori, me ndonjë veprim konkret, ka dalë që ka ndihmuar në mbarëvajtjen e organizimin e këtij aktiviteti? Ka nxjerrë ndonjë karrige ndonjë tavolinë nga shkolla? Ka qenë ndonjë pjestar i stafit? Ka ndonjë gjë nga këto? Apo është ashtu siç thotë ai që aty është një oborr i hapur pa roje pa derë dhe pas orarit ata kanë gjetur një shesh të lirë si i thonë.


Z. Y. Merkaj: Atëherë, drejtori i shkollës mund t'i kryjë shkeljet edhe me mosveprime. Ideja që nuk ka komunikuar me organizatorët për t'i thënë që nuk do të futeni. Shkolla është rrethuar me mur rrethues dhe ka një derë të jashtme me çelës. Fakti që kjo derë nuk është shqyer por është hapur, tregon që drejtori i shkollës e ka vënë në dispozicion oborrit e shkollës. Kemi aktivitetin dhe murin rrethues të shkollës.

Z. K. Bele: Meqë ju keni këtë provë duhet ta hetonit që është neglizhenca e rojes apo e personit që hap dhe mbyll derën. Drejtori e hap dhe e mbyll derën e gardhit?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka roje shkolla, as në strukturën organizative nuk ka roje.

Z. K. Bele: Më fal, thellohemi te këto pyetje, sepse ne kuptojmë vështirësitë që ka hetimi në një rast të tillë, në një fshat në një zonë malore. Është pozitive që ka një praktikë të konsoliduar të KAS-it për sanksionimin e të gjithave rasteve kur ambiente publike qofshin këto shkolla, spitale, ambulanca janë përdorur për qëllime elektorale. Ne me këtë nuk duam të zhbëjmë apo të vemë në pikëpyetje si rolin e denoncuesve, qoftë Qëndresa apo të tjerë, ashtu dhe hetimin e KQZ-së. Nga ana

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

tjetër ne duhet të balancojmë dhe prandaj po e bëj këtë parantezë, duhet të balancojmë. E para, duhet të vërtetojmë përtej dyshimit të arsyeshëm, që personat janë përfshirë me formën e veprimit apo mos veprimit, që ju me të drejtë e thatë. Nga ana tjetër, duhet të jemi dhe propocional e të balancuar në mënyrën tonë të analizës, për të kuptuar që qëllimi është të ndalohet përdorimi i asetit dhe jo të ndalojmë kryerjen e fushatës nga kushdo qoftë pala pjesëmarrëse në këtë proces. Pra, kjo është ajo që dua unë personalisht, por edhe kolegët, nga sa kuptova nga pyetjet, që duan të arrijmë. Pra, nuk është qëllimi që çdo rast i propozuar për sanksion të marrë gjobën e cila është gjithsesi shumë modeste. Pra lidhja është shkaksore, bindemi s'bindemi se na ka ndodhur dhe gabime ka. Më mirë të plotësojmë një praktikë, e të mos japim një shkelje të sanksionuar, sesa të japim shkelje afrofe, vjen njoftimi dhe vendosim atë gjobën simbolike dhe kryejmë punë.

Z. Y. Merkaj: Thjesht e kemi provuar dhe në shqyrtimin administrativ pasi nga drejtori i shkollës është vënë në dispozicion pasuri e paluajtshme, sipas Kodit Zgjedhor neni 142, si dhe asetet që janë në pronësi të enteve dhe të organeve shtetërore siç është dhe shkolla.

Z. K. Bele: Dakord, ky është qëndrimi juaj, e kuptova! Më fal nga përfaqësuesi ka ndonjë koment?

Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Po, në të njejtën linjë me KQZ-në, pretendojmë dhe besojmë që drejtori i shkollës ka pasur dijeni, ose më saktë me mosveprim e ka lejuar mbarëvajtjen e aktivitetit dhe Partia Socialiste e ka përdorur si burim. Në vetë emailin që drejtori i shkollës dërgon, shprehet “me përfundimin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

procesit mësimor kemi mbyllur derën e shkollës, kemi ikur në shtëpi. Theksojmë se shkolla nuk ka roje dhe asnjë nga pjesëmarrësit e stafit pedagogjik nuk është banor i fshatit që të pengonte pjesëmarrësit që të hynin në oborrin e shkollës”. Tani ose ka pasur një thyerje të hyrjes, pra në shkollë, nga ana e Partisë Socialiste dhe që ndoshta duhet denoncuar në organet kompetente, ose provohet që drejtori nuk e ka zbatuar detyrën e tij dhe është përgjegjës, sepse ka dijeni për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti.

Z. K. Bele: Në fëmijërinë timë kur luanim në oborret e shkollës, kujtoj se oborret kanë qenë të hapuara nuk e di si është sot, por me derë ndoshta kanë parasysh derën e brendshme pastaj jashtë.. a kanë mbyllur derën e brendshme apo derën e jashtme kjo është një gjë që ndoshta...

Z. I. Rusmali: Dera e jashtme në gjuhën e drejtorit quhet “portë”. Për të dyja palët ju keni dijeni në çfarë ore është zhvilluar aktiviteti nga hetimi që rezulton për secilën palë?


Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se është zhvilluar pas orës 14:00.

Z. I. Rusmali: Nga ka dalë kjo gjë?

Z. Y. Merkaj: E-maili i drejtorit dhe përgjigjja e Zyrës Arsimore.

Z. I. Rusmali: Në rregull nga këto dy dokumente. Qëndresa Qytetare ka dijeni nga hetimi i vet, për këtë gjë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Kemi dijeni që është zhvilluar në datën 3, në referim të shkresës që është dërguar nga ZPA-a...

Z. I. Rusmali: Edhe ju keni të njejtin burim informacioni, keni të njejtin dokumentacion. Karriget që janë përdorur për t'u ulur publiku në këtë aktivitet, keni dijeni nga janë marrë.

Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se karriget nuk janë të shkollës.

Z. I. Rusmali: Nuk janë karrige të shkollës. Jeni ndalur tek kjo çështje, apo është përfundim që e nxirrni tani?

Z. Y. Merkaj: Nuk është vënë në diskutim, por duke parë fotot dhe karriget që ka shkolla dhe karriget që janë përdorur këtu... duke qenë se nuk ka pas ndonjë diskutim për këtë pjesë, mendojmë se nuk janë të shkollës.

Z. I. Rusmali: Dakord! Qëndresa ka ndonjë hetim për karriget?

Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Të paktën nga aq njohuri sa kemi, nuk rezultojmë të jenë karriget e shkollës.

Z. I. Rusmali: Nga ju del kjo gjë?

Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Nga fotot.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. I. Rusmali: Nga fotot dhe ju. Dakord! Për administratën, KQZ-ja do me thënë hetimi administrativ e ka trajtuar kandidatin në cilësinë e tij si subjekt elektoral, thuhet në material, në kërkesë. Denoncuesi e ka trajtuar kandidatin në cilësinë e tij si subjekt elektoral, thuhet në denoncim apo jo? Në përfundim të hetimit dhe kur parashtroni kërkesën ndaj KAS-it, kërkonti që ai të mos sanksionohet, me sanksionin që i përket subjektit elektoral, po të sanksionohet me sanksion tjetër. Keni motiv për këtë kalim nga cilësimi si subjekt elektoral, tek cilësimi person i ngarkuar me detyra?

Z. Y. Merkaç: E kemi trajtuar si kryetari i bashkisë, jo si kandidat.

Z. I. Rusmali: Në material thuhet në cilësinë e tij si kandidat, jo si kryetar i bashkisë. Veprimtaria nuk është e bashkisë. Kryetari i bashkisë, nuk ka marrë pjesë si kryetar bashkie, thuhet në materialin tuaj, ka marrë pjesë si kandidat. Denoncimi është për kandidatin qartazi, në bazë të ligjit është subjekt elektoral, pse më pas del person i ngarkuar me detyra.

Z. Y. Merkaç: Duke qenë se i ka pasur të dy postet dhe të kandidatit dhe të kryetarit të bashkisë.

Z. Y. Merkaç: Dakord, zgjodhët njërën!

Z. L. Braho: Kam një pyetje për të dyja palët, referuar dhe përgjigjes që dhatë për zotin Rusmali në lidhje me nga e keni marrë dijeninë për orarin e aktivitetit. Ju pranoni e-mailet e drejtorisë rajonale dhe e-mailin e drejtorit, i pranoni si provë dhe si të vërteta në momentin që ato referojnë për orarin e aktivitetit? Ndërkohë që nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

i pranoni si provë dhe si të vërteta në lidhje me faktin e dijenisë apo të pa dijenisë së drejtorit. Keni ndonjë provë tjetër në lidhje me mosveprimin e tij?

Z. Y. Merkaj: Nuk është e vërtetë që i kemi marrë si prova. Kemi marrë provë përgjigjen e Zyrës Vendore Arsimore, e kemi marrë si provë dhe të gjitha pretendimet që ka bërë zyra arsimore, i kemi provuar që i ka të gjitha të vërteta. Në lidhje me drejtorinë e shkollës mendojmë që ka pasur dijeni dhe i është shmangur përgjigjes dhe përgjegjësisë.


Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Nga ana jonë ne e pranojmë si provë, por e pranojmë në tërësinë e vetëm, madje vetë ZVAP-ja por edhe drejtori i shkollës në këndvështrimin tonë, kanë pranuar faktin që me mosveprimin të paktën, kanë lejuar kryerjen e atij aktiviteti duke qenë se dera ka qenë e mbyllur pretendojnë ata. Në të njejtën kohë thonë pastaj që nuk mund t'i pengonim dot të hynin, faleminderit!

Z. K. Bele: Në këtë fazë nuk kemi më pyetje, mbyllim shqyrtimin administrativ, përfundimisht, Ylli çfarë kërkoni?
Jepni qëndrimin tuaj!

Z. Y. Merkaj: Ne kërkojmë marrjen e masave administrative sipas propozimit të Komisionerit për kandidatit ose kryetarin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe drejtorit të Shkollës "Fran Murrizi". Faleminderit!

Z. K. Bele: Nga përfaqësuesit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Për kandidatin kërkojmë sanksionimin e tij sipas pikës 1, të nenit 172, si subjekt zgjedhor, në ndryshim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ndërkohë që, për drejtorin e shkollës kërkojmë sanksionimin e tij sipas pikës 2, të nenit 171. Faleminderit!

Z. K. Bele: Atëherë, KAS do të tërhiqet për shqyrtim dhe për vendim dhe do t'u thërrasim për një kohë rreth 15 minuta.

Rifillon seanca

Ora, 13:48


Z. K. Bele: Riçelim seancën, KAS, në përfundim të shqyrtimit administrativ vendosi:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur sanksione administrativ për kandidatin Zotin Tonin Marinaj, në mbështetje të nenit 172, pika 1, të Kodit Zgjedhor, dënimin me gjobë në masën 100 mijë lekë.
- Rrëzimin e kërkesës për vendosjen e sanksioneve administrativ për zotin Kastriot Dragaj, me detyrë drejtor i shkollës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

Me kaq seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 186

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

**26.10.2023
Ora 13:49**

RENDI I DITËS


**"Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 33, datë
19.10.2023".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S'ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita! Çelim seancën e shqyrtimit në themel për kërkesën nr. 33 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për vendosje sanksioni administrativ", ndaj kryetarit të Bashkisë Maliq, zotit Gëzim Topçiu, në masën 3 mijë lekë. Verifikojmë fillimisht prezencën është prezent trupa e plotë e KAS-it. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Nuk është prezent personi ndaj të cilit propozohet sanksioni administrativ. Nga administrata jam i informuar që dikush i cili nuk është i identifikuar në shkresë, ka paraqitur në rrugë elektronike, pra nëpërmjet e-mailit, pretendimet, përpara Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me anë të të cilave kundërshton propozimin e Komisionerit. Kështu që dikush do të na i lexojë shkurtimisht dhe pretendimet e personit ndaj të cilit propozohet sanksioni, në mënyrë që të respektojmë edhe barazinë e armëve në këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

proces administrativ. Atëherë, i japim fjalën Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, i cili do të parashetrojë shkurtimisht, arsyet pse Komisioneri ka propozuar sanksionin, ndaj kryetarit të Bashkisë Maliq. Zoti Merkaj, fjala për ju!

Z. Y. Merkaj: Bfaleminderit! Bashkia Maliq, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 25.03.2023, veprimtari publike me objekt si më poshtë: takim pune nr. 1 të banorëve të Njesisë Administrative Pojan, raportuar në datën 24.04.2023 për t'u zhvilluar në datën 28.04.2023. Takim pune nr. 2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, raportuar me datën 24.04.2023, për t'u zhvilluar në datën 28.04.2023 ora 16:00. Inspektim punimesh nr. 1 në Njesisë Administrative Pojan, raportuar në datën 24.04.2023 dhe për t'u zhvilluar në datën 28.04.2023. ora 11:00. Inspektim punimesh nr. 2 për Njesisë Administrative Pojan ,të raportuar në datën 24.04.2023 për t'u zhvilluar në datën 28.04.2023. Kontroll punimesh në Njesisë Administrative Libonik, raportuar në datën 25.04.2023 për t'u zhvilluar në datën 29.04.2023 ora 16:00. Takim pune me banorët e Njesisë Administrative Gore Muglicë, raportuar në datën 25.04.2023 për t'u zhvilluar në datën 29.04.2023 ora 10:00. Inspektim punimesh në Qytetin Maliq, raportuar në datën 25.04.2023 për tu zhvilluar në datën 29.04.2023 ora 15:00. Sapo është vënë në dijeni Komisioneri për këto raportime, me vendimin nr. 413 datë 25.04.2023 ka vendosur ndalimin e zhvillimit të veprimtarive publike të planifikuara për të zhvilluar sipas datave të raportimit nga institucioni pasi ka qenë në afatin e parashikuar nga ligji prej 5 ditësh. Në vijim të procedurave administrative i është dërguar ky vendim Bashkisë Maliq, pra vendimi i Komisionerit, për ndalimin e veprimtarive të ndaluara. Më tej në datë 25.04.2023 në faqen e KQZ-së janë raportuar, janë administruar dy denoncime të ardhura ndërmjet postës elektronike, ku pretendohet zhvillimi i këtyre aktiviteteve që janë të ndaluara në Bashkinë Maliq.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Konkretisht janë denoncuar në denoncimin e regjistruar nr. 417, ku është denoncuar se është kryer një zhvillim, një takim elektoral me banorët e fshatit Plasë, për asfaltimin e rrugëve, rehabilitimin e terreneve sportive, rehabilitim ambulance Plasë, zhvillimin e rehabilitimit të rrjetit të ujësjellsit Plasë, ku në takim kanë qenë dhe drejtuesi politik i qarkut, deputeti i qarkut dhe kryetari i Këshillit të Qarkut të Korçës. Gjithashtu në denoncim është dhe pika 2, pjesa e dytë e denoncimit, ku është denoncuar se zoti Gëzim Topçiu, kryetar në detyrë në Bashkinë Maliq ka zhvilluar në datën 28.04.2023 takimin nr. 1, takimin nr. 2 pune, me Njësinë Administrative Pojan, inspektim punimesh në Njësinë Administrative Pojan, si dhe inspektim punimesh në Njësinë Administrative Pojan. Këto takime duke qenë se u shqyrtua paraprakisht çështja është vlerësuar se këto indicie dhe informacione i ka të dhëna, që tregojnë bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, Komisioneri ka zhvilluar hetimin administrativ, duke kërkuar informacione Bashkisë Maliq në lidhje me aktivitetet që referuam pak më lart. Titullari pretendon se nuk i ka kryer ato veprimtari publike, por ka vazhduar me takime elektorale me banorët e njësive administrative të ndryshme Pojan, Libonik dhe Muglicë. Gjatë shqyrtimit administrativ është thirrur personi përgjegjës për raportimet për t'u paraqitur në KQZ në hetimin administrativ dhe nuk i është përgjigjur kërkesës për bashkëpunim. Në lidhje me takimin e parë, ku kanë marrë pjesë edhe drejtuesi politik i Qarkut të Korçës, deputeti i Qarkut të Korçës dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut të Korçës, Komisioneri ka vlerësuar se janë takime elektorale, janë të organizuara nga bashkia dhe nuk përbëjnë shkelje dhe për këtë arsye ka vendosur të pushohet shqyrtimi administrativ në lidhje me pikën 1 të denoncimit. Në lidhje me pikën 2 të denoncimit për këto zhvillime elektorale të kryetarit të bashkisë me banorë të Njësisë Administrative Pojan, Libonik dhe Moglicë, Komisioneri vlerëson se është shkelur pika 4 e nenit 4 të vendimit nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, duke qenë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

se këto veprimtari kanë qenë veprimtari të ndaluara dhe kryetari i Bashkisë Maliq nuk duhet t'i zhvillonte këto veprimtari pasi kanë qenë të ndaluara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Edhe nëse do të zhvillonte veprimtari jo me karakter publik, por edhe natyrës elektorale, atëherë zhvillimi i këtyre veprimtarive nuk duhet të përkojë me atë të cilat ishin ndaluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për këto arsye, Komisioneri ka vendosur t'i propozojë KAS-it sanksion administrativ në masën 3 mijë lekë, parashikuar nga neni 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit zoti Merkaj! Një pyetje meqenëse jemi këtu, që ta kemi të qartë, Komisioneri ka propozuar gjobën vetëm për faktin që megjithëse veprimtaritë ishin të ndaluara, subjekti nuk ka respektuar urdhrimin e Komisionerit Shtetëror për t'i ndaluar këto veprimtari. Dakord, edhe një pyetje tjetër meqenëse jemi, Komisioneri ka konstatuar që personi përgjegjës për raportimin megjithëse është thirrur në KQZ nuk i është përgjigjur thirrjes së Komisionerit dhe nuk është paraqitur në KQZ apo jo? Po ndaj këtij, sigurisht kjo i përket ndoshta Komisionerit për të dhënë përgjigjen më të qartë, nuk e ka konsideruar mosbashkëpunim me KQZ-në Komisioneri në kuptim të nenit 169, të Kodit dhe të propozonte një sanksion edhe për këtë person?


Z. Y. Merkaj: Ideja është se personi përgjegjës i është përgjigjur në e-mail kërkesës..

Z. E. Çefa: Është përgjigjur por nuk ka ardhur fizikisht?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka ardhur fizikisht, është e drejta e tij, nuk mund ta...

Z. E. Çefa: Qartë, dakord! Ka pyetje nga kolegët?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. I. Rusmali: Unë e kam të vështirë ta kuptoj këtë histori. Për denoncimin e parë të zotit Spaho, cili ka qenë pretendimi i zotit Spaho?

Z. Y. Merkaj: Zoti Spaho ka pretenduar se të dyja këto janë aktivitete të ndaluara, të cilat kanë qenë të ndaluara nga Komisioneri dhe janë zhvilluar...

Z. I. Rusmali: Për pretendimin e parë jo për të dyja, mos i fut të dyja. Gjëja e parë, ka dy denoncime zoti Spaho?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Rusmali: Denoncimin e parë, çfarë kërkonte me këtë denoncim? Ku ishte shkelja sipas tij?

Z. Y. Merkaj: Ka pretenduar që kjo veprimtari ka qenë veprimtari publike, duhet të ishte raportuar në KQZ... dhe ka qenë e ndaluar nga Komisioneri. Ky është pretendimi i zotit Spaho. Në fakt Komisioneri nuk e ka ndaluar këtë veprimtari, sepse e ka konsideruar si veprimtari elektorale ku kanë marrë pjesë dhe drejtuesit politikë të subjektit zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Pra, veprimtaria elektorale e kandidatit dhe për shkak se është veprimtari elektorale e kandidatit, nuk ka shkelje të Kodit nuk ka vend për sanksione. Kalojmë te denoncimi i dytë, edhe denoncimi i dytë është i të njejtës natyrë nga zoti Spaho apo jo? Denoncimi i dytë ka një dallim, bashkia e ka raportuar aktivitetin për të gjitha dhe aktiviteti është ndaluar. Pastaj është zhvilluar gjithsesi. Në shpjegimet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

e veta personi përgjegjës ka thënë që “ne morëm dijeni për ndalimin, ne respektoam ndalimin dhe i shndërruam veprimtaritë nga veprimtari të bashkisë, në veprimtari zgjedhore elektorale, veprimtari të kandidatit, këtë ka thënë ai. Ju çfarë i hidhni poshtë këtij pretendimi?

Z. Y. Merkaj: E para, këto janë raportuar në faqen e KQZ-së si veprimtari publike, jo elektorale dhe janë zhvilluar të njejtën orë dhe në të njejtën datë që janë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe që kanë qenë të ndaluara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim. Fakti që janë bërë në këtë orë dhe në këtë datë janë të ndaluara. Megjithatë Komisioneri ka arsyetuar te vendimi i tij që edhe pse do të zhvillohej veprimtaria jo me karakter publik, siç janë ato që pretendon kryetari i bashkisë, me karakter i natyrës elektorale, atëherë zhvillimi i i tyre nuk duhet të përkonte me atë që ka ndaluar Komisioneri.

Z. I. Rusmali: Këtë ta sqarojmë të fundit, diku thuhet se është verifikuar dhe ka rezultuar që nuk ishin veprimtari të karakterit elektorale.

Z. Y. Merkaj: Po, sepse vetë kryetari i bashkisë, në raportimin që ka bërë ka thënë që “janë veprimtari me karakter publik dhe unë prandaj po i raportoj në KQZ”.

Z. I. Rusmali: Dakord, këto kanë qenë më përpara se të ndaloheshin. Ngjarjet rrodhën, prapa personi përgjegjës tha “ne i shndërruam në veprimtari elektorale”. Ju nga zhvillimi i tyre ju rezulton se nuk kanë qenë elektorale.

Z. Y. Merkaj: Nuk kanë qenë elektorale, kanë qenë publike...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. I. Rusmali: Si e nxorrët këtë konkluzion?

Z. Y. Merkaç: Sepse kanë qenë banorët e Njësisë Administrative: Pojan, Libonik dhe Moglicë është folur për asfaltim rrugësh..

Z. I. Rusmali: Po pse teknike dhe jo elektorale?

Z. Y. Merkaç: Po, sepse kështu na është raportuar që në fillim dhe publike kanë qenë.

Z. I. Rusmali: Mos ka qenë gabim raportimi, mbase kanë qenë të projektuara që në fillim veprimtari elektorale?

Z. Y. Merkaç: Ndoshta.


Z. I. Rusmali: Shkojmë te kjo çështja e fundit se kjo është e rëndësishme. Ju thoni se nuk mund, pavarësisht nga rrëmuja, në fund fare nuk mund të zhvillojë veprimtari elektorale në të njëjtën orë, në të njëjtën datë, me ato që më përpara i ka deklaruar si veprimtari publike. Pse nuk mund ta bëjë këtë gjë?

Z. Y. Merkaç: Sepse përveç këtyre që thatë ju që janë të njëjta është dhe tematika që është raportuar...

Z. I. Rusmali: Kush e ndalonte ta bëjë këtë gjë?

Z. Y. Merkaç: Sepse në pamje të parë edhe sikur mos të jetë veprimtari publike, ajo është e ndaluar në atë orë dhe në atë datë, nga Komisioneri, sepse është e njëjta.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Mund ta zhvillojë veprimtarinë elektorale por të paktën 1 orë më mbrapa, 2 orë më mbrapa, një ditë tjetër. Po në atë orë dhe në atë datë nuk mundet, sepse duke përkuar me atë orë është konsideruar që është veprimtari e raportuar dhe e ndaluar nga Komisioneri. Duke qenë të njejtët persona, të njejtët aktorë, si dhe e njejtë tematikë.

Z. I. Rusmali: Sepse bie ndesh me ndalimin e vendosur...


Z. Y. Merkaj: Nga Komisioneri.

Z. I. Rusmali: Pra, dhe ndryshimi i natyrës nuk ndryshon asgjë tek fakti që është vendosur një ndalim për atë vendndodhje dhe për atë rreth grup personash.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka. Atëherë nga administrata zonja Osmanaj do të na lexoni shkurtimisht pretendimet e personit ndaj të cilit... në mënyrë që ta respektojmë.

Znj. I. Osmanaj: Atëherë, po referoj të gjitha pretendimet që janë depozituar ndërmjet adresës elektronike nga personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë Maliq, ndërmjet së cilës bën me dije se: Referuar detyrimit që parashikon neni 92, i ligjit nr. 1019, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Bashkia Maliq, ka respektuar detyrimin për të raportuar të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Personi përgjegjës për raportim në faqen e KQZ-së ka respektuar detyrimin të publikojë veprimtaritë publike të institucionit dhe jo takimet elektorale që ka zhvilluar vetë titullari i institucionit. Sipas vendimit nr. 795 datë 06.10. 2023, bazuar në denoncimin nr. 417 ID është marrë vendimi, se aktivitet e raportuara nga Bashkia Maliq konkretisht: takim pune me banorët e Njesisë Administrative Pojan,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

takim pune me banorët e Njësive Administrative në lidhje me inspektimin e punimeve të datës 28.04.2023, ora 11:00 dhe takimi i tretë që ka të bëjë me takim me banorët e Njesisë Administrative Maliq, dt 28.04.2023, ora 12:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit Njësia Administrative Pojan, janë aktivitete të ndaluara. Së pari, theksojmë se: referuar këtyre aktiviteteve të ndaluara u kemi kthyer përgjigje me e-mail pranë KQZ-së se këto takime nuk janë zhvilluar, por është vazhduar me takim elektorale dhe në njësi të ndryshme administrative nga ana e titullarit të Bashkisë Maliq. Së dyti, këto veprimtari të ndaluara nga KQZ-ja, nuk janë transmetuar apo pasqyruar në rubrikat e lajmeve, apo në rubrika që mbulohen fushatën në radio televizive, sipas ligjit për transmetues në radio televiziv. Provat e paraqitura nga ana e subjektit denoncues se këto aktivitete janë publikuar në faqen e Facebook-ut të titullarit nuk qëndrojnë, pasi ajo është një faqe personale e titullarit që publikon aktivitete, foto, informacione të ndryshme të cilat nuk duhet të ngatërrohen me raportime zyrtare pranë KQZ-së, pjesën e detyrimeve ligjore që parashikon Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Fotot e publikuara janë në vazhdimësi të takimeve elektorale që kryetari i bashkisë ka zhvilluar gjatë periudhës 30 ditore të fushatës zgjedhore dhe nuk e referon aktiviteteve të raportuara apo të ndaluara pranë faqes zyrtare të KQZ-së. Për këto arsye, kundërshtojmë marrjen e masës administrative nga ana e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, një pyetje kam unë, bashkëlidhur e-mailit kishte ndonjë provë tjetër shtesë nga Bashkia Maliq?

Znj. I. Osmanaj: Jo vetëm ky e-mail.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. E. Çefa: Faleminderit, po zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Bashkia pretendon që ngjarjet nuk përkojnë. Kështu e dëgjova unë pretendimin e bashkisë. Ju, si e provoni që përkojnë? Nga e provoni që përkojnë?

Z. Y. Merkaç: Gjatë shqyrtimit administrativ janë marrë në shqyrtim të gjitha provat dhe një nga provat që ka marrë Komisioneri që ka vlerësuar dhe shqyrtuar është dhe raporti monitoruesit të caktuar. Monitoruesi në raportin e tij ka raportuar që kjo veprimtari është zhvilluar me të njejtët persona, me të njejtët faktorë, në të njejtin vend dhe me të njejtin objekt veprimtarie.

Z. I. Rusmali: Mbase unë nuk jam familjar me raportimin. Monitoruesi, siç e shoh unë këtu thotë, “nuk vura re që të zhvillohej ndonjë takim nga ato që janë të ndaluara”.


Z. Y. Merkaç: Denoncimi ka 2 pika, pikën e parë, pika A dhe pika B. Mendoj se kjo është për pikën e parë.

Z. I. Rusmali: Po, pika e parë nuk ishte veprimtari e ndaluar.

Z. Y. Merkaç: Ishte denoncuar nga denoncuesi dhe ai ka marrë në shqyrtim.

Z. I. Rusmali: Mos na ngatërroni, e para nuk ka qenë veprimtari e ndaluar. Veprimtaritë e denoncimit të dytë kanë qenë veprimtari të ndaluara. Institucionia i komunikon denoncimeve në datën 12.05.2023 me e-mail dhe me disa persona të tjerë nga stafi këtu dhe i thotë... në ditën e premte me datën 12.05.2023 i thotë: “sipas

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

raportit të monitorimit rezulton se këto aktivitete nuk janë zhvilluar” dhe bashkëlidh raportin e monitorimit, atë që lexuam pak më parë. Do të thotë se instiucionia e konfirmon raportin e monitorimit, do të nxirrni ndonjë raport tjetër ndërkohë?

Z. E. Çefa: Atëherë pezullojmë seancën për pak minuta sa të vijë prova e kërkuar nga anëtari i KAS.

Rifillon seanca


Ora, 14:21

Z. E. Çefa: Riçelim seancën dhe menjëherë fjalën e ka administrata e KQZ-së për të sqaruar pak pyetjen e kolegut, zotit Rusmali.

Z. Y. Merkaç: Kemi pasur një paqartësi tek shpjegimet që bëmë, pasi raporti i monitoruesit bën fjalë vetëm për pikën 1, që është për pushimin i shqyrtimit nga Komisioneri, ndërsa provat e marra gjatë shqyrtimit administrativ për pikën 2 që është bërë dhe kërkesa “për vendosje sanksioni administrativ”, janë marrë nga faqja e rrjetit social “Facebook” të kryetarit të bashkisë, si dhe provat e sjella nga denoncuesi në seancë.

Z. I. Rusmali: Dakord, do të thotë, raportin e monitorimit nuk e marrim fare në konsideratë, sepse nuk ka pretendime nga ana juaj për pikën e parë. Ju e konsideroni të ligjshme veprimtarinë për pikën e parë. Tani, te pika e dytë, ju jeni mbështetur te provat e Facebook-ut të kryetarit të bashkisë, fotografitë nga ky rrjet për të konsideruar që veprimtaritë përkojnë. Kryetari i bashkisë thotë që veprimtaritë nuk përkojnë dhe Facebook nuk e tregon dot këtë. Çfarë thoni ju?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*


Z. Y. Merkaj: Duke parë fotot, duke parë dhe datën e zhvillimit që përkojnë me orën dhe me datën e ndalimit nga Komisioneri është krijuar bindja që kjo veprimtari ka qenë veprimtari që është ndaluar nga Komisioneri. Atëherë, te faqja e Facebook-ut të kryetarit të bashkisë thotë: “Gëzim Topçiu, data 28 Prill mes banorëve të një lagjeje të Pojanit. Veprimtaritë e Komisionerit për vendimin nr. 413, bën fjalë për veprimtari të zhvilluara në Njësinë Administrative Pojan, takim pune me banorët e Njësisë Administrative Pojan në datën 28.04.2023 dhe inspektim punimesh me banorë të Njësisë Administrative Pojan. Është vetë kryetari i bashkisë që i ka postuar...

Z. I. Rusmali: Që të përkojnë aktivitetet duhet të përkojnë, duhet të jenë të zhvilluar në të njejtën orë. Faqja e Facebook-ut është postim i datës 28 prill në të cilin janë postuar disa fotografi dhe është vënë ky shënim. Si provohet që këto fotografi i përkasin aktivitetit të zhvillur në orën 14:00 të datës 28 prill?

Z. Y. Merkaj: Bëhet fjalë për një denoncim që ka dy pjesë. Pjesa e parë që janë bërë takime elektorale që është bërë pushimi i shqyrtimit administrativ për banorët e Njësisë Administrative Plasë. Në faqen e Facebook-ut të nxjerra nga kryetari i bashkisë, bëhet fjalë për takime të ndaluara nga Komisioneri në Njësinë Administrative Pojan, e thotë vetë kryetari i bashkisë që janë bërë në Pojan. Këto që janë në Pojan, në Libonik dhe në Moglicë janë veprimtari që i ka ndaluar Komisioneri dhe janë bërë në datën 28 prill, sepse në 28 është bërë dhe postimi dhe shpjegimi në postim që shtë bërë në datën 28.

Z. I. Rusmali: Pretendimi është që në momentin që ka deklaruar një aktivitet në datën 28 prill, në orën 14:00 në Pojan, i cili është ndaluar, kryetari i bashkisë nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

duhet të shkelte në Pojan gjatë gjithë ditës? Apo mund të shkonte atje në orën 16:00 dhe të takonte njerëz?

Z. Y. Merhaj: Jo gjatë gjithë ditës, por të paktën me objekt veprimtarie, tematikën për takim pune, për inspektim punimesh, nuk duhet ta zhvillonte.

Z. I. Rusmali: Nga u del ju, që ai ka shkuar dhe ka bërë një veprimtari me këtë tematikë?

Z. Y. Merhaj: Sepse thotë “Në mes banorëve në një nga lagjet e Pojanit, vlerësim për punët e realizuara. Asfaltimi i tre rrugëve...” dhe “.. shiko më poshtë thotë..” dhe te tematika që ka raportuar...

Z. I. Rusmali: Po ajo “shiko më poshtë”, çfarë është?

Z. Y. Merhaj: Ka treguar 16 fotografitë që tregojnë që... “rehabilitim të stacionit të pompave, Pojan” thotë, “Kanalet beton ujitës, rehabilitim ambulance, rehalibitim i shkollës Pojan”, dhe në fund “Faleminderit për banorët”. Ka dhe 16 foto që tregon takimet me banorët e Njësisë Administrative Pojan dhe fotografitë që ilustron dhe provon se ka pasur takime me vende publike.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera nuk ka. Atëherë, ne mund t’i japim fund dhe hetimit administrativ. Për konkluzionet përfundimtare zoti Merhaj, i qëndroni kërkesës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. Y. Merkaç: Po, i qëndrojmë kërkesës së Komisionerit për t'i propozuar KAS-it, në marrjen e sanksionit administrativ në masën 3.000 lekë për Kryetarin e Bashkisë Maliq, zotin Gëzim Topçiu.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë do ta ndërpresim sërish seancën këtu, për t'u ritakuar pas 10-15 minutash. Ndërkohë KAS do të tërhiqet për vendim.

Rifillon seanca

Ora, 14:41

Z. E. Çefa: Çelim seancën për shpalljen e vendimit. KAS-i pasi diskutoi çështjen në tërësi me shumicë votash vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës nr. 33 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për vendosjen e sanksionit administrativ gjobë, në masën 3.000 lekë, ndaj kryetarit të Bashkisë Maliq zotit Gëzim Topçiu.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- Ndaj këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit, brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 187

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

26.10.2023

Ora 14:42

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 34, datë
19.10.2023”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S’ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Përshëndetje, çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 34, të datës 19.10.2023. Kërkesë që ka të bëjë me denoncimin nr. 402 ID, të KRIIK-ut. Është denoncim ndaj Bashkisë Kamëz, për të cilën pretendohen se nuk janë raportuar veprimtari publike në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar KAS-it marrjen e masës administrative ndaj zotit Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Kamëz, gjobë në masën 3.000 lekë. Gjithashtu ka bashkëlidhur dhe vendimin për shqyrtimin administrativ të këtij denoncimi. Denoncimi është i datës 08.05.2023 dhe kërkesa është e datës 19.10.2023. Atëherë, zoti Merkaj është i pranishëm dhe përfaqëson

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

administratën e KQZ-së. Ka dijeni ky personi ndaj të cilit kërkohet dënimi, zoti Elvis Gjika? Apo Bashkia Kamëz?

Z. Y. Merkaj: I kemi dërguar me e-mail komunikimin personit përgjegjës.

Z. L. Braho: Zotit Elvis Gjika, ka adresë personale? A është në dijeni për seancën e sotme?

Z. Y. Merkaj: Atëherë personi përgjegjës që ka detyrimin t'ia përcjellë zotit Elvis Gjika komunikimin, ne i kemi dërguar e-mail.

Z. L. Braho: S'kemi asnjë reagim? Ka e-mail për seancën e sotme?

Z. Y. Merkaj: Po.


Z. L. Braho: Meqenëse pala ka dijeni, nuk është i pranishëm, kështu që... ka pasur ndonjë reagim, prapësime, pretendime?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk ka pasur.

Z. L. Braho: Mirë atëherë, fjala për ju zoti Merkaj, që të na bëni një argumentim më të detajuar sa ky që relatova unë, për kërkesën e Komisionerit.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka vlerësuar denoncimin nr. 402 ID, me kërkesë të KRIIK-ut, ndaj Bashkisë Kamëz, në të cilën pretendohet se nuk janë raportuar veprimtari publike në ndërfaqen e KQZ-së, të dedikuar për këtë qëllim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi e ka shqyrtuar paraprakisht çështjen, ka vlerësuar se dokumentacioni dhe të dhënat e treguara krijojnë bazë të mjaftueshme për një hetim administrativ. Ka filluar hetimin administrativ duke i kërkuar informacion Bashkisë Kamëz në lidhje me këtë denoncim. Në përgjigje të kërkesës sonë, nga Bashkia Kamëz është informuar se “Është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarive në fjalë me karakter publik..” thotë, “...sa më sipër nga ana e Bashkisë Kamëz është raportuar në ndërfaqen e raportimit, Panairi i librit “Kamza Lexon”. Paqartësia e denoncuesit është krijuar për shkak se ky aktivitet është shtyrë dhe është kryer disa ditë më vonë se sa data e raportimit. Në ndërfaqen e raportimeve do të shihet se ky raportim është raportuar si aktivitet”. Në vijim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri ka zhvilluar seanca dëgjimore në datat: 11.05.2023, 27.07.2023, 06.10.2023 dhe asnjë nga palët nuk është paraqitur për të shpjeguar dhe për të dhënë shpjegime në seancën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të denoncimit me nr. 402 ID, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit është vlerësuar se veprimtaria e denoncuar është veprimtari publike, në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Bashkia Kamëz në përgjigje të saj ka sqaruar se “Ky aktivitet është raportuar”. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se, Bashkia Kamëz ka kryer dy aktivitete të këtij lloji, të cilat rezultojnë se: në rastin e parë është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, ndërsa në rastin e dytë për ngjarjen “Kamza Lexon” nuk është kryer raportimi. Në këto kushte, Komisioneri ka vlerësuar se kjo është veprimtari publike dhe mbart detyrimin për t’u raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor “Institucioni publike qendrore dhe vendore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik”. Gjithashtu referuar pikës 3, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

“Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucionit”. Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, meqënëse personi i cila ka qenë i ngarkuar nga detyra për të raportuar, nuk ka kryer këtë raportim, ka propozuar KAS-it të dënohet me gjobë 3.000 lekë, sipas nenit 171, pika 1, Kodi Zgjedhor.

Z. L. Braho: Faleminderit, tani që të qartësohemi pak më tepër! Bëhet fjalë për këtë, i njejti aktivitet është aktiviteti “Kamza Lexon”, që është zhvilluar në ditë të ndryshme dhe është raportuar vetëm një herë? Te denoncimi ka një status Facebook-u...

Z. Y. Merkaj: Është i njejti aktivitet që ka pasur dy edicione. Edicioni i parë dhe edicioni i dytë. Edicioni i parë është raportuar, kurse edicioni i dytë “Kamza Lexon”, nuk është raportuar.

Z. L. Braho: Atëherë, ky aktiviteti “Me Linditën në mesin e shkrimtarëve në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit “Kamza Lexon”, me një larmishmëri aktivetesh, emocione do të vijojë dhe në datat 06 dhe 07 maj, me të pranishëm Besnik Mustafaj, Ben Blushi, Namik Dokle. Të lumtur që Kamza për të dytin vit radhazi promovon rëndësinë e librit”. Pra, edicioni i dytë, duhet të jetë viti i dytë. Kështu që viti i parë ka qenë viti 2022? Cili është raportuar dhe cili nuk është raportuar nga hetimi që ju e keni kryer?

Z. Y. Merkaj: Aktiviteti “Kamza Lexon” nuk është raportuar.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Z. L. Braho: Statusi në Facebook është aktiviteti? Cili është raportuar pastaj? Mund të na e identifikoni?

Z. Y. Merkaj: Raportimi i parë është bërë në datën 23 mars 2023.

Z. L. Braho: Aktiviteti i kujt date është?

Z. Y. Merkaj: Aktiviteti i datës 14 prill.

Z. L. Braho: 14, 15 dhe 16 prill. Ky është aktiviteti i raportuar dhe është “Kamza Lexon” te panairi i librit?

Z. I. Rusmali: Te statusi që denoncohet thuhet që “Ky do të vazhdojë dhe me një aktivitet të datës 5, 6 dhe 7 Maj”. Është pjesë e edicionit të dytë dhe 6, 7 Maj është “Kamza Lexon”.


Z. L. Braho: Ky nuk është raportuar. Po e keni verifikuar ju është bërë aktiviteti i 6-7 Majit? Argumenti i tyre është që e kemi raportuar një herë për të dyja fazat?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. L. Braho: Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Denoncimi nr. 402 ID, ka këtë status. Statusin për njoftimin e edicionit të dytë të panairit. Statusi vetë referon te dy etapa të aktivitetit do të thotë, statusi njofton publikisht zhvillimin e aktivitetit të datës 14, 15, 16 prill. Ky status

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

njofton këtë aktivitet. Ky status denoncohet, për aktivitetin e datës 14, 15, 16 prill, apo jo?

Z. Y. Merkaj: Denoncohet aktiviteti i datës 6-7 maj.

Z. I. Rusmali: Në qoftëse ju thoni që denoncimi i referohet veprimtarisë së datës 6-7 maj, ne kemi një problem këtu, sepse statusi nuk përkon pastaj me denoncimin. Statusi thotë..., prezanton panairin. Prezanton të dy fazat e panairit “Me Linditën jemi këtu..”, faza e parë dhe “...do të vazhdojmë me 6-7 maj me Besnikun dhe Ben Blushin”. Tani faza e parë është raportuar. Denoncimi ka lidhje me fazën e parë që është raportuar, nuk ka lidhje me fazën e dytë që do të vijojë. Ju e keni shtjelluar hetimin dhe e keni parë a ka ndodhur raportim për datën 6-7 maj?

Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit ka rezultuar që ka ndodhur në datën 6-7 maj dhe kryesisht KQZ-ja dhe mund ta shtrijë hetimin...

Z. I. Rusmali: Dakord, si e keni provuar që në 6-7 maj ka ndodhur efektivisht?

Z. Y. Merkaj: Se është përgjigjja e Bashkisë Kamëz.

Z. K. Bele: Nuk e kuptoj ky postim nga është shkëputur? Është adresë e bashkisë, kryetarit? Facebook i kujt? Këtu nuk thuhet gjëkundi. Këtu është një link që nuk thotë gjë.

Z. L. Braho: Pezullojmë pesë minuta seancën sa të mbledhim provat.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Rifillon seanca

Ora, 15:10

Z. L. Braho: Riçelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisioneri në lidhje me një denoncim në Bashkinë Kamëz. Tani nga materialet që na u vunë në dispozicion, kemi një aktivitet që është postuar në faqen e kryetarit të Bashkisë Kamëz dhe kandidatit për kryetar të Bashkisë Kamëz njëkohësisht, në datën 5 Maj. Ky është një aktivitet me disa shkrimtarë dhe me moton “Kamza Lexon”. Është një aktivitet që siç duket përderisa është postuar në datën 5 maj dhe në aktivitet citohet që do të vazhdojë dhe në datën 6-7 maj. Pra është një aktivitet tre ditor. Ndërkohë në raportimet që janë bërë në portalin e KQZ-së ka qenë një aktivitet tre ditor në datat 14, 15 dhe 16 prill që është raportuar se do të zhvillohet në sheshin “Nënë Tereza”, Kamëz. Të pranishëm do të ishin kryetari i bashkisë, shkrimtarë, drejtoresha e Pallatit të Kulturës, qytetarë... nuk raportohet ndonjë titull i aktivitetit. Nga faqja e Facebook-ut e zotit Rakip Suli dhe Bashkisë Kamëz nuk rezulton që të jetë organizuar ndonjë aktivitet tre ditor me shkrimtarë në datat 14, 15, 16 prill. Megjithatë administrata e KQZ-së besoj në hetimin 5-mujor që i ka bërë kësaj çështje, përderisa vijon për kërkesën për të vendosur gjobë, ka dhe informacion tjetër a mund të jetë publikuar në vend tjetër ky aktiviteti i datave 14,15,16 prill, ose më saktë si e provojmë se ky aktivitet është zhvilluar, përveç pjesës që rezulton këtu.

Z. Y. Merkaj: Nuk ka indicie tjetër që të jetë zhvilluar në datën 14,15,16 prill. Thjesht duke marrë për bazë edhe pranimin dhe deklarimin e personit përgjegjës të Bashkisë Kamzës, që ka thënë se është shtyrë në këtë datë; mendojmë që ky aktivitet i shtyrë, duhet të ishte raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas datave që do të zhvillohej në datat 5, 6 dhe 7 maj. Për këtë arsye është denoncuar si veprimtari e pa raportuar.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 26.10.2023*

Dakord, faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Nuk ka! Mirë, KAS tërhiqet për vendim, në orën 15:30 shpallim vendimin.

Riçelet seanca

Ora, 15:25

Z. L. Braho: Përshëndetje, riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës nr. 34. KAS pasi u tërhoq për vendim, vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 34, datë 19.10.2023.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve.

U shpall sot, më datë 26.10.2023.

Seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 188

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

